



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 198, Datë 19.06.2023

MBI

SHTYRJEN E AFATIT TË PARASHIKUAR NË KONTRATËN PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES (OSSH) SH.A.

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.06.2023, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike me nr. 1748/2 prot., datë 16.06.2023 “Mbi pezullimin e zbatimit të afatit të parashikuar në kontratën për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë të OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES (OSSH) sh.a., miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s 343, datë 21.12.2022”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 257, datë 21.12.2020, ka miratuar Programin e Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., ndërsa me vendimin nr. 343, datë 21.12.2022, bordi i ERE-s ka miratuar Kontratën për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a., ku në pikën 3.1.1 të saj përcaktohet se: Zyrtari ka për detyrë, ndër të tjera dhe hartimin e një raporti vjetor, ku përcaktohen masat e marra për zbatimin e Programit dhe dorëzimin e këtij raporti në ERE dhe tek Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 114, datë 27.03.2023, ka miratuar emërimin e Z. Ervis Hazizi, si Zyrtar i Pajtueshmërisë (ZP), të shoqërisë “OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES” sh.a. dhe për arsye të sqarimit të ZP mbi mënyrën e përgatitjes së raportit meqenëse është raportimi i parë për Z. Hazizi, në ERE më datë 12.06.2023 u mbajt një seancë dëgjimore me praninë e Z. Hazizi, përfaqësues të OSSH sh.a. dhe përfaqësues të ERE-s.
- Zyrtari i Pajtueshmërisë deklaroi se ka nisur puna për mbledhjen e të gjithë informacionit të nevojshëm për të përgatitur raportin, i cili do të depozitohet në ERE brenda 1 muaji, pra brenda datës 12.07.2023.

- Për gjithë sa e argumentuar vlerësohet të shtyhet zbatimi i afatit të parashikuar në pikën 3.1.1, të Kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sha, deri jo më vonë se data 12.07.2023. Kjo shtyje afati vlen vetëm për dorëzimin e Raporti vjetor të pajtueshmërisë për vitin 2022.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të shtyjë afatin e parashikuar në pikën 3.1.1, të Kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë të OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES (OSSH) sh.a., jo më vonë se data 12.07.2023.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë Zyrtarin e Pajtueshmërisë së shoqërisë OSSH sh.a. dhe Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI